



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 746 datë 20.11.2019

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 294, DATË 08.04.2015 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të marrëveshjes mes qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtimin dhe Zhvillim, për bashkëpunimin në mbështetje të klimës së investimeve dhe qeverisjes së mirë, nënshkruar në 24 shkurt 2014, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 294, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 5, gërma “a)”, “i”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“i. institucione shtetërore, 4 anëtarë:

- ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Banka e Shqipërisë;
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;
- Fondi Shqiptar Për Zhvillimin e Diasporës.

2. Pika 5, gërma “a)”, “iii”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“iii. Dhoma të Tregtisë dhe Industrisë, 3 anëtarë:

- Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë;
- Dhoma e Biznesit të Diasporës.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA